

Montis

Kolegji ESLG

MEMORANDUM PËR BASHKUNIM DHE NJOHJE TË NDËRSJELLËT

NDËRMJET

Kolegji "ESLG"- Prishtinë
dhe
"Montis" SH.P.K

I. Qëllimi i Memorandumit

1. Me këtë memorandum palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin e mirë dhe gatishmërinë për bashkëpunim dhe njojje të ndërsjellët, duke synuar arritjen e standardeve evropiane dhe ndërkombe të menaxhimit të patundshmërive, praktikave më të mira pë vlerësimin e patundshmërive, infrastrukturës së energjisë, eficiencës së energjisë, qëndrueshmërisë dhe mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit efikas të sektorit ndërtimor dhe atij të energjisë;

II. Fushëveprimitaria

Bashkëpunimi i ndërsjellët i palëve do të realizohet në këto fusha:

1. Montis SH.P.K zotohet se do të ofrojë këshillat e saj për përpilimin e planprogrameve moderne të lëndëve përkatëse në programin Menaxhimi i Patundshmërise dhe Infrastrukturës (BA) dhe (MA) dhe Menaxhimi i Energjisë niveli bachelor;
2. Montis SH.P.K zotohet se do të ofrojë praktikën për studentët e programit Menaxhimi i Patundshmërise dhe Infrastrukturës (BA) dhe Menaxhimi i Energjisë (BA), Menaxhimi i Patundshmërise dhe Infrastrukturës (MA) dhe Menaxhimi i Energjisë (BA);
3. Montis SH.P.K zotohet se do të zhvillojnë projekte të përbashkëta hulumtimi me profesorët dhe studentët e Kolegjit ESLG.;
4. Montis SH.P.K dhe ESLG do t'i ofrojnë ndihmë njëri-tjetrit në fushën e vlerësimit të pronave të paluajtshme.
5. Stafi akademik i Kolegjit ESLG ofron ndihmën këshilldhënëse për Montis SH.P.K dhe gjithashtu do të bashkëpunojnë në hulumtime dhe analiza të përbashkëta të cilat janë në favor të sektorit privat;

6. Montis SHPK do të udhëzojë bashkëpunëtorët e vet që të avansohen në nivelin akademik në kuadër të programeve unike të Kolegjit ESLG;
7. Organizimi i përbashkët i aktiviteteve në fusha të ndryshme nëpërmjet simpoziumeve, konferencave, debateve rreth standardeve dhe praktikave më të mira në fushën e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare të menaxhimit të paluajtshmërive dhe menaxhimit të energjisë;
8. Qasje në projekte të ndërsjellta, nëpërmjet të cilave do t'u mundësohet pedagogëve, studentëve dhe stafit udhëheqës dhe menaxhues, të kenë mundësi të përfshihen në projekte të përbashkëta që do të ndërmerren nga Kolegji "ESLG" dhe Montis SHPK;
9. Konkurrimi në projekte të përbashkëta vendore, ndërkombëtare, nëse ndërmjet palëve ekziston vullneti dhe dëshira.

III. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

1. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuara sipas këtij Memorandumi, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuar me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnje informacion, dokument apo të dhëna ndonjërisht palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me fryshten e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër.
2. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellët me besueshmëri të plotë.

IV. Dispozitat e Fundit

1. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim apo keqinterpretim në realizimin e këtij Memorandumi do të zgjidhet në fryshten e tolerancës, mirëkuptimit dhe brenda kuadrit të etikës morale;
2. Ky Memorandum hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit;
3. Ky Memorandum është përpiluar në katër kopje identike, dhe secila palë merë nga dy kopje.

Prishtinë, më 24.03.2019

PALËT NËNSHKRUËSE

Montis SHPK

Drejtore

Kastriot Ruhani



Kolegji "ESLG"

Rektor

Prof. Asist. Dr. Visar Hoxha



Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Kolegjit ESLG dhe Montis SHPK